

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ –Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtari individual Musa Konxheli dhe bashkëpunëtorja profesionale Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në lëndën penale kundër të akuzuarve R.L. dhe A.S., për shkak të veprës penale vjedhja nga neni 325 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2625-7/16 të datës 10.01.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor me datë 24.04.2017 në prezencë të Prokurorit të Shtetit Sebahate Sinani dhe të akuzuarve R.L. dhe A.S., shpall dhe publikisht komunikon këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit

R.L., nga Ferizaj rr ‘.....’ pn, data e lindjes.....në fshatin, komuna e Kaçanikut, nga i ati N. dhe e ëma Z. e gjinisë Z., pa martuar, i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

A.S., nga fshati, K.Ferizaj ku edhe tani jeton, data e lindjes....., nga i ati K. dhe e ëma U. e gjinisë A., pa martuar, i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

me datë 29 tetor 2016, rreth orës 20.00 h, në rrugën ‘ Dëshmorët e Kombit’ në Ferizaj, të pandehurit në bashkëkryerje, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, kanë kryer vjedhje në dëm të dëmtuarit D.B., në atë mënyrë që nga oborri i xhamisë së madhe ia vjedhin biçikletën të cilën më pas e shesin tek i pandehuri i tretë B.B., ndërsa të dëmtuarit i shkaktojnë dëm material në shumë prej 40 euro,

me të cilën ka kryer veprën penale vjedhja nga neni 325 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së

Andaj gjykata ne baze të neneve 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74, 75, 76 , 83 të KPRK-ës, dhe nenit 365, lidhur me nenin 31 të KPPK-ës,

Të pandehurve R.L. dhe A.S. u

SHQIPTON

DËNIM BURGIMI SECILI NË KOHËZGJATJE PREJ 1/NJË/MUAJ, i cili dënimi i shqiptuar me burg do te filloj të ekzekutohet menjëherë/konform nenit 367 par.2 te KPPRK-se, pasi aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

Obligohet i pandehuri që të dëmtuarit D.B. ti paguaj shumën në vlerë prej 40 € (katër dhjete) €, në emër të dëmit të shkaktuar, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Të akuzuarit R.L. dhe A.S. obligohen që në emër të shpenzimeve ta paguajnë paushallin gjyqësor secili në shumën prej 20/njëzet/ euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzë PP/II.nr.2625-7/16 të datës 10.01.2017, ka akuzuar të pandehurit R.L. dhe A.S. për veprën penale vjedhja nga neni 325 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor fillestar me datë 24.04.2017, në të cilën shqyrtim të akuzuarit janë deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza, shprehin keqardhjen dhe janë penduar thellë për

veprën e kryer, i premtojnë gjykatës që në ardhmen nuk do të përsërisin vepra të tilla penale, lus gjykatën që të iu shqiptoj një dënim sa më të butë.

Pasi që të akuzuarit kanë pranuar fajësinë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë dhe shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se, të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurve, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit dhe atë: vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve si dhe vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht i datës 29 dhjetor 2016 si dhe të bëhet shiqimi në fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës.

Meqenëse të akuzuarit kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale **vjedhja nga neni 325 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë, shpreh keqardhjen dhe janë penduar thellë për veprën e kryer, sjelljen korrekte gjatë tërë procedurës, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, vetë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe me dënimin e shqiptuar me burg do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet në dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Obligohen të pandehurit që të dëmtuarit D.B. ti paguaj shumën në vlerë prej 40 € (katër dhjete) €, në emër të dëmit të shkaktuar, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Të akuzuarit R.L. dhe A.S. obligohen që në emër të shpenzimeve ta paguajnë paushallin gjyqësor secili në shumën prej 20/njëzet/ euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë është vendosur si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.47/17 me datë 24.04.2017

**Bashkëpunëtorja profesionale,
Mirlinda Bytyqi Rexhepi**

**Gjyqtari,
Musa Konxheli**

Këshilla juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15/pesëmbëdhjete/ditësh.